Blv. Zhan d'Ark , nr. 3
Tiranë, 1001
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2228300

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Indeksi i Çmimeve të Konsumit*

## Janar, 2017

**Tiranë, më 08 Shkurt 2017:** Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Janar 2017, arriti 103,7 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Në muajin Janar 2017 ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit është 2,8 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,5 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




**Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.** Rritja vjetore e çmimeve në muajin Janar është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me + 2,33 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Transporti" kanë kontribuar me +1,17 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Mallra dhe shërbime të ndryshme" kanë kontribuar me +0,15 pikë përqindje. Çmimet e grupeve "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" dhe "Argëtim e kulturë" kanë kontribuar secili me nga + 0,08 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Pije alkoolike dhe duhan" kanë kontribuar me +0,04

**Për publikim 08/02/2017**

* *Në Indeksin e Çmimeve të Konsumit, Janar 2017 janë reflektuar disa ndryshime metodologjike, të cilat mund t'i gjeni në faqen 4*

pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Shërbimi arsimor” kanë kontribuar secili me nga +0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Komunikimi” dhe “Shëndeti” kanë kontribuar secili me nga + 0,01 pikë përqindje.

## Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor




**Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore:** Krahasuar me muajin Janar 2016, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 5,8 %, pasuar nga grupet “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 3,2 %, “Argëtim e kulturë” me 3,1 %, “Transport” me 2,8 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,9 %, etj. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet“ u rritën me 24,8 %, pasuar nga nëngrupet “fruta” me 8,8 %, “sheqer, reçelna e ëmbëlsira” me 6,6 %, “qumësht, djath e vezë” me 4,9 %, etj. Nga ana tjeter çmimet e nëngrupit “vajra dhe yndyrna” u ulën me 1,8 %, pasuar nga nëngrupi “mish” me 0,5 %.

**Ndryshimi mujor i indeksit është + 1,5 %.** Krahasuar me muajin Dhjetor 2016 rritja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me 3,7 %. Ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin “Veshje dhe këpucë” me -1,0 %.

## Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100

| Kodi | Grupet | Peshat | 01-16 | 02-16 | 03-16 | 04-16 | 05-16 | 06-16 | 07-16 | 08-16 | 09-16 | 10-16 | 11-16 | 12-16 | 01-17 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Gjithsej** | **100,0** | **100,9** | **102,0** | **102,5** | **102,0** | **100,8** | **100,2** | **100,2** | **101,1** | **101,5** | **101,2** | **101,3** | **102,2** | **103,7** |
| 1 | Ushqime dhe pije joalkoolike | 40,0 | 102,5 | 105,9 | 107,0 | 105,9 | 102,4 | 100,4 | 100,4 | 102,8 | 103,1 | 102,4 | 101,9 | 104,6 | 108,5 |
| 2 | Pije alkoolike dhe duhan | 4,4 | 100,5 | 100,8 | 101,2 | 100,8 | 100,9 | 101,0 | 101,0 | 100,9 | 100,9 | 101,1 | 100,9 | 101,3 | 101,4 |
| 3 | Veshje dhe këpucë | 4,0 | 99,4 | 98,1 | 98,4 | 98,3 | 98,4 | 98,3 | 98,1 | 98,1 | 99,9 | 100,3 | 100,6 | 100,9 | 99,9 |
| 4 | Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji | 20,7 | 100,7 | 100,7 | 100,7 | 100,6 | 100,5 | 100,4 | 100,3 | 100,2 | 100,4 | 100,5 | 101,5 | 100,9 | 101,1 |
| 5 | Mobillje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | 6,5 | 100,3 | 100,3 | 100,0 | 100,3 | 100,3 | 100,3 | 100,5 | 100,5 | 100,2 | 99,6 | 100,2 | 100,2 | 100,3 |
| 6 | Shëndeti | 3,0 | 100,0 | 100,1 | 100,2 | 100,2 | 100,0 | 100,2 | 100,1 | 100,0 | 100,1 | 100,0 | 100,2 | 100,2 | 100,3 |
| 7 | Transporti | 6,2 | 96,7 | 95,8 | 96,3 | 96,3 | 97,2 | 98,6 | 99,4 | 99,8 | 99,5 | 99,6 | 99,5 | 99,2 | 99,4 |
| 8 | Komunikimi | 2,5 | 100,0 | 100,0 | 100,3 | 99,9 | 99,9 | 100,0 | 99,9 | 99,9 | 100,5 | 100,5 | 100,7 | 100,6 | 100,2 |
| 9 | Argëtim dhe kulturë | 2,6 | 100,2 | 100,1 | 100,1 | 100,2 | 100,2 | 100,9 | 101,7 | 101,4 | 101,7 | 101,2 | 100,9 | 102,3 | 103,3 |
| 10 | Shërbimi arsimor | 2,5 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 99,9 | 100,4 | 100,7 | 100,7 | 100,7 |
| 11 | Hotele, kafene dhe restorante | 2,9 | 100,0 | 100,0 | 100,0 | 100,1 | 100,1 | 100,1 | 100,1 | 100,1 | 100,1 | 100,1 | 100,0 | 100,1 | 100,1 |
| 12 | Mallra dhe shërbime të ndryshme | 4,7 | 100,0 | 100,1 | 100,1 | 100,2 | 100,3 | 100,2 | 100,0 | 100,4 | 103,3 | 103,1 | 103,1 | 103,3 | 103,2 |

## Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

| Kodi | Grupet | 01-16 | 02-16 | 03-16 | 04-16 | 05-16 | 06-16 | 07-16 | 08-16 | 09-16 | 10-16 | 11-16 | 12-16 | 01-17 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Gjithsej** | **1,5** | **0,2** | **0,3** | **0,3** | **0,7** | **1,2** | **1,9** | **2,0** | **1,8** | **1,5** | **1,9** | **2,2** | **2,8** |
| 1 | Ushqime dhe pije joalkoolike | 4,3 | 2,2 | 2,2 | 2,0 | 2,3 | 2,7 | 4,3 | 4,7 | 3,7 | 3,1 | 3,2 | 4,6 | 5,8 |
| 2 | Pije alkoolike dhe duhan | 3,3 | 2,6 | 2,6 | 1,7 | 1,6 | 1,4 | 1,7 | 1,4 | 1,4 | 1,6 | 1,5 | 1,3 | 0,9 |
| 3 | Veshje dhe këpucë | -3,7 | -3,4 | -2,3 | -2,3 | -1,9 | -1,5 | -1,3 | -0,4 | 1,4 | 1,0 | 0,8 | 0,9 | 0,6 |
| 4 | Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji | -1,3 | -1,3 | -0,9 | 0,5 | 0,5 | 0,2 | 0,0 | 0,0 | 0,1 | 0,5 | 1,5 | 0,9 | 0,4 |
| 5 | Mobillje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | 0,9 | 1,1 | 0,7 | 0,8 | 0,7 | 0,9 | 1,0 | 0,8 | 0,8 | 0,3 | 0,7 | 0,2 | -0,1 |
| 6 | Shëndeti | -1,6 | -2,2 | -2,2 | -2,5 | -2,8 | 0,5 | 0,1 | -0,1 | -0,2 | -0,5 | 0,2 | 0,2 | 0,2 |
| 7 | Transporti | -2,5 | -4,1 | -4,5 | -5,3 | -4,7 | -3,6 | -3,3 | -2,2 | -1,7 | -1,5 | -0,5 | -0,8 | 2,8 |
| 8 | Komunikimi | -1,1 | -1,0 | -0,7 | -1,1 | -1,2 | -1,0 | -1,2 | -0,1 | 0,5 | 0,5 | 0,7 | 0,6 | 0,2 |
| 9 | Argëtim dhe kulturë | 1,2 | 0,7 | 0,8 | 0,9 | 0,8 | 1,6 | 2,8 | 2,4 | 1,7 | 1,0 | 0,8 | 2,3 | 3,1 |
| 10 | Shërbimi arsimor | 4,8 | 4,8 | 4,8 | 4,8 | 4,8 | 4,8 | 4,8 | 4,4 | 3,8 | 0,4 | 0,7 | 0,7 | 0,7 |
| 11 | Hotele, kafene dhe restorante | 1,0 | 1,0 | 1,0 | 1,1 | 1,1 | 1,0 | 1,0 | 0,8 | 0,1 | 0,1 | 0,1 | 0,1 | 0,1 |
| 12 | Mallra dhe shërbime të ndryshme | -0,1 | 0,2 | 0,2 | -0,1 | -0,1 | -0,1 | 0,1 | 0,7 | 2,6 | 3,0 | 2,7 | 3,3 | 3,2 |

**Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit**

%

| Kodi | Grupet | 01-16 | 02-16 | 03-16 | 04-16 | 05-16 | 06-16 | 07-15 | 08-16 | 09-16 | 10-16 | 11-16 | 12-16 | 01-17 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Gjithsej** | **0,9** | **1,1** | **0,4** | **-0,4** | **-1,2** | **-0,6** | **0,1** | **0,9** | **0,3** | **-0,2** | **0,1** | **0,9** | **1,5** |
| 1 | Ushqime dhe pije joalkoolike | 2,5 | 3,3 | 1,1 | -1,1 | -3,4 | -1,9 | 0,1 | 2,3 | 0,3 | -0,7 | -0,5 | 2,7 | 3,7 |
| 2 | Pije alkooike dhe duhan | 0,5 | 0,3 | 0,4 | -0,4 | 0,1 | 0,1 | 0,0 | -0,1 | 0,0 | 0,2 | -0,3 | 0,4 | 0,1 |
| 3 | Veshje dhe këpucë | -0,6 | -1,3 | 0,4 | -0,1 | 0,1 | -0,1 | -0,3 | 0,0 | 1,8 | 0,4 | 0,3 | 0,3 | -1,0 |
| 4 | Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji | 0,7 | 0,0 | 0,0 | -0,1 | -0,1 | -0,1 | -0,1 | 0,0 | 0,2 | 0,1 | 1,0 | -0,6 | 0,2 |
| 5 | Mobililje, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë | 0,3 | 0,0 | -0,3 | 0,2 | 0,0 | 0,0 | 0,2 | 0,0 | -0,2 | -0,6 | 0,6 | 0,0 | 0,1 |
| 6 | Shëndeti | 0,0 | 0,1 | 0,1 | 0,1 | -0,2 | 0,2 | 0,0 | -0,2 | 0,1 | -0,2 | 0,3 | -0,1 | 0,1 |
| 7 | Transporti | -3,3 | -0,9 | 0,5 | 0,0 | 0,9 | 1,5 | 0,8 | 0,4 | -0,3 | 0,1 | -0,1 | -0,3 | 0,2 |
| 8 | Komunikimi | 0,0 | 0,0 | 0,3 | -0,4 | 0,0 | 0,2 | -0,1 | 0,0 | 0,6 | 0,0 | 0,2 | 0,0 | -0,4 |
| 9 | Argëtim dhe kulturë | 0,2 | -0,1 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,7 | 0,8 | -0,3 | 0,3 | -0,5 | -0,3 | 1,4 | 0,9 |
| 10 | Shërbimi arsimor | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | -0,1 | 0,5 | 0,3 | 0,0 | 0,0 |
| 11 | Hotele, kafene dhe restorante | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,1 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | 0,0 | -0,1 | 0,0 | 0,0 |
| 12 | Mallra dhe shërbime të ndryshme | 0,0 | 0,1 | -0,1 | 0,1 | 0,1 | 0,0 | -0,2 | 0,3 | 2,9 | -0,1 | -0,1 | 0,2 | 0,0 |

## SHPJEGIME METODOLOGJIKE

- **Ndryshime metodologjike**

Në muajin Janar të çdo viti, Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime të bazuara në metodologjinë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, si më poshtë:

- Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2015.
- Lista e mallrave dhe shërbimeve është përditësuar, në 332 mallra dhe shërbime nga 333 që ishte në vitin e kaluar.
- Përditësimin e listës tregtare ku mblidhen çmimet.

**Përkufizime**

**Indeksi i Çmimeve të Konsumit** (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri. Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve. IÇK në vitin **t** llogaritet me strukturën e shpenzimeve të vitit **(t-1)**

**Ndryshimi vjetor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj

**Ndryshimi mujor** mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korent me muajin e mëparshëm. Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

**Ndryshimi mesatar 12 mujor** mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.